



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Prishtinë 11.01.2021

## **Termet e referencës**

### **Ekspert për inxhinieri të ndërtimitarisë/infrastrukturës rrugore**

#### **Qëllimi i angazhimi afatshkurtër të inxhinierit të jashtëm**

Zyra Kombëtare e Auditimit është duke planifikuar auditimin e performancës nëse rrugët lokale janë ndërtuar me kohë, kosto të arsyeshme dhe cilësi.

Për shkak të fushës dhe njohurive specifike që kërkohen për kryerjen e këtij auditimi, Zyra Kombëtare e Auditimit kërkon angazhimin e një eksperti të inxhinierisë së ndërtimitarisë/infrastrukturës rrugore.

Kohëzgjatja e angazhimit të ekspertit është 14 ditë pune.

#### **Përshkrimi i punës dhe detyrat kryesore të “ekspertit të ndërtimit të rrugëve (më tutje eksperti)”**

Eksperti duhet të përkrahë ekipin e auditimit për të vlerësuar nëse sistemi aktual siguron nivel optimal në cilësi, kosto dhe kohë gjatë ndërtimit të rrugëve rajonale dhe lokale në Kosovë.

Eksperti në veçanti duhet të përkrahë ekipin me udhëzime për fazën e parastudimit, ekzekutimit të auditimit dhe raportimit me fokus të veçantë në ekzaminim fizik të projekteve/rrugëve të audituara.

Eksperti po ashtu duhet të ofrojë ekspertizën në aspekt të ofrimit të informatave rreth praktikave të mira në ndërtimin e rrugëve lokale dhe/ose rajonale.

Eksperti i ndërtimit të rrugëve ndër të tjera duhet të promovojë praktikat efikase duke rekomanduar përmirësime për mangësitë që identifikohen.

Ndër të tjera, përgjegjësi të ekspertit në mbështetje të ekipi janë:

- Vlerësimi nëse projektet e hartuara për rrugët lokale janë adekuate dhe sipas standardeve përkatëse (ndërkombëtare/të aplikuara) për ndërtimin e rrugëve;
- Vlerësimi nëse projektet (rrugët) e audituara janë ndërtuar me kohë dhe me kosto optimale; dhe
- Vlerësimi për cilësinë e projekteve/rrugëve që do të auditohen.

Eksperti po ashtu duhet të:

- Ofroj ekspertizën gjatë procesit auditues dhe të jetë prezent kur është e nevojshme gjatë fazës së planifikimit dhe ekzekutimit të auditimit;
- Përpiloj letrat e punës në bazë të standardit që aplikon ZKA po ashtu duhet siguruar dëshmi të mjaftueshme dhe relevante lidhur me të gjeturat dhe të gjitha dëshmitë duhet të jenë të dokumentuara;
- Veprojnë në përputhje me kodin e etikës që aplikohet në ZKA;
- Jetë i gatshëm t'i përgjigjet kërkesave të tjera që mund të dalin nga faza e ekzekutimit (puna në teren) dhe që konsiderohen të nevojshme për nevoja të auditimit siç janë pjesëmarrja në takime me ekipin, me palët e audituara, si dhe komunikimi i vazhdueshëm me ekipin e auditimit.

### **Përgatitja e raportit**

Raporti i ekspertit do të fokusohet në prezantimin e të dhënave dhe analizave mbështetëse në një vëllim të veçantë, nëse është e nevojshme. Duhet të përfshijë një përmbledhje ekzekutive që diskuton shkurtimisht gjetjet e rëndësishme dhe veprimet e rekomanduara. Struktura e sugjeruar e raportit është e përshkruar më poshtë:

- Përmbledhja e përgjithshme;
- Qasja dhe metodologjia e përdorur;
- Politikat, ligjet, rregulloret, standardet;
- Analizat e kryera;
- Çështjet e dala nga ekspertiza dhe ndikimet, dhe
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

### **Kërkesat e punës**

- Diplomë universitare në lëminë e ndërtimtarisë, me përparësi drejtimi i inxhinierisë së infrastrukturës rrugore;
- Minimum 5 vite përvojë punë në fushën përkatëse, pas diplomimit;
- Të ketë dëshmi se ka **hartuar/menaxhuar** së paku 3 projekte nga lëmia e kërkuar (hartimi i projekteve për: ndërtimin e rrugëve, urave dhe objekteve tjera përcjellëse për rrugët-preferohet përvoja në rrugë rajonale dhe lokale; dhe
- Letër motivuese, të kete gatishmëri të punojë në ekip dhe në mënyrë të pavarur.

### **Kandidatët e interesuar duhet të bashkëngjisin këto dokumente:**

- Biografi (CV);
- Letër motivuese;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë për studimet universitare;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse për periudhën e kërkuar;
- Kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka); dhe
- Referenca për punët e mëparshme në lëminë e hartimit/menaxhimit të projekteve apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.